



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

STRATEGJIA E KULTURËS 2017 - 2020

Prizren, Shkurt 2017

Përmbajtja
Lista e shkurtesave
Terminologjia dhe konceptet kryesore
Përmbledhja ekzekutive
I.Hyrje
II.Analiza e gjendjes
2.1. SWOT Analiza
2.2. Vështim mbi gjendjen e sektorit të kulturës në komunën e Prizrenit
2.3. Përmbledhje e Dokumenteve Relevante Ekzistuese Strategjike Lokale dhe Qendrore
III.Vizioni, Synimet dhe Objektivat
Sistemi i Objektivave Strategjike	
3.1.1. Objektiva strategjike I: Rritja e pjesëmarrjes dhe çasjes në jetën kulturore
3.1.2. Objektiva strategjike II: Zhvillimi i Turizmit Kulturor dhe Ekonomisë Kulturore
3.1.3. Objektiva strategjike III: Reforma e Qeverisjes së Kulturës
IV.Metodologjia e zbatimit të strategjisë
V.Referencat

Lista e shkurtesave

KP	Komuna e Prizrenit
DKRS	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
DF	Drejtoria e Financave
DShP	Drejtoria e Shërbimeve Publike
DTZHE	Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik
OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile
RrOK	Rrjeti i Organizatave të Kulturës
QRTK	Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Drafti punues i parë

Terminologjia dhe konceptet kryesore

Në mënyrë që ti shmangemi ndonjë keqkuptimi të mundshëm gjatë interpretimit të pjesëve të caktuara të strategjisë, janë përcaktuar disa kushte themelore metodologjike të përdorura në këtë dokument. Kjo është bërë për të harmonizuar më lehtë të menduarit në lidhje me çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me vizionin dhe misionin e politikës kulturore të qytetit, si dhe të gjithë strategjinë kulturore.

Kultura

Më gjerësisht përfshin të gjitha format e shprehjes artistike dhe intelektuale, dhe kontribuon në artikullimin e identitetit të komunitetit duke inkurajuar një ndjenjë të përkatësisë dhe lidhje mes njerëzve përmes modeleve të sjelljes civile dhe të civilizuar. Kultura ruan zakonet, traditat dhe adetet tradicionale sociale, por edhe në vazhdimësi inicon nevojën për të krijuar përmbajtje dhe produkte të reja, me qëllim më të mirë të bashkëjetesës, ku të gjithë individët kanë të drejta të barabarta në veprim ose pjesëmarrjes.

Kultura përmes trashëgimisë materiale dhe jomateriale bashkon njerëzit e të gjitha profileve dhe besimeve duke u ofruar atyre vlera të vjetra dhe vlera të krijuara rishtazi, si dhe inkurajimin e tyre për të komunikuar përmes dialogut krijues - "këtu dhe tani", duke e ndër-lidhur të kaluarën me të ardhmen.

Vizioni

Ajo paraqet një deklaratë koncize që përshkruan se çfarë ideale ne duam të arrijmë. Kjo është një pjesë e rëndësishme e strategjive të zhvillimit dhe drejtimit strategjik. Është vlerësuar sipas kriterëve të mëposhtme: i orientuar drejt së ardhmes bazuar në supozime të arsyeshme, të arritshme, të përshtatshme, frymëzuese, të dobishme dhe ambicioze.

Misioni

Ai paraqet një deklaratë koncize që përshkruan hapat dhe obligimet që do të marrë mbi vehte institucioni për të arritur vizionin. Flitet më shumë rreth institucionit që përcakton qëllimin e tij dhe mënyrën e funksionimit.

Objektivat strategjike

Ky term nënkupton atë që duhet të arrihet në fushën e kulturës në qytetin e Prizrenit dhe zonës përreth për të nxënë hapin më të rëndësishëm cilësor në krahasim me sasinë aktuale dhe brenda çdo prioriteti individual.

Masat

Drejtoria për Kulturë e qytetit të Prizreni së bashku me drejtoritë tjera të saj, të gjitha institucionet tjera dhe shoqatat e pavarura në kulturë si dhe të gjithë përdoruesit e buxhetit të qytetit, punojnë në mënyrën më të mirë për arritjen e objektivave strategjike në fushën e kulturës.

Treguesit e performancës / treguesit

Këto janë instrumente vlerësimi dhe monitorimi të masave të ndërmarra. Kjo do të ofrojë një pasqyrë të qëndrueshme në procesin e arritjes së qëllimeve, si në afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Edhe pse shifrat raportohen në numër dhe tregues të tjerë të vlefshëm të suksesit, kultura zakonisht nuk është e natyrës së logaritjeve matematikore.

Preferencat

Prioritetet është konsideruar të jetë veprimi më i gjerë i mundshëm në kuadër të kësaj strategjie i cili është arritur me anë të dialogut dhe harmonizimin e mendimeve të të gjithë akterëve relevant në të gjithë jetën institucionale dhe shoqërore.

Përmbledhje Ekzekutive

Strategjia Komunale e Prizrenit për Kulturë 2017 -2020 është një strategji gjithëpërfshirëse e Komunës së Prizrenit në fushën e Kulturës, që synon vendosjen e kulturës ndër shtyllat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të Komunës së Prizrenit, përmes orientimit rreth një vizioni të arritshëm dhe objektivave që çojnë në realizimin e tij.

I realizuar me bashkëpunimin e Komunës së Prizrenit me Rrjetin e Organizatave Kulturore në Prizren, ky proces është përbërë nga hulumtime, intervista, punëtori, debate dhe aktivitete të ndryshme ku kanë marrë pjesë akterë të ndryshëm siç janë: Kuvendi Komunal i Prizrenit, DKRS, DTZhE, Biblioteka Komunale, QRTK-ja, RDA-ja, Info Qendrat si dhe një pjesë e madhe e organizatave kulturore të qytetit. Duke i marrë për shembull modele dhe studime nga organizata si UNESCO, Agenda 21, Komisioni Europian, si dhe nga qytete të ndryshme në rajon, Europë dhe më gjerë, ky dokument i përfshin praktikat më të zhvilluara të qeverisjes, planifikimit dhe orientimit kulturor, duke e njohur kulturën si shtyllë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, demokracisë, mirëqenies sociale dhe ndërkombëtarizimit të qytetit.

Strategjia është ideuar si mekanizëm për implementim të Planit Zhvillimor Komunal si dhe Strategjive tjera relevante, duke e ofruar një model të ri dhe të integruar qeverisës që përfshin fusha si arsimi, ekonomia, mjedisi, përfshirja sociale, trashëgimia kulturore, turizmi dhe urbanizmi. Dokumenti i definon politikat kulturore të Komunës së Prizrenit dhe parimet kryesore siç janë:

- Kultura prioritet dhe shtyllë e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror
- Kultura e çasshme për të gjithë
- Edukim kulturor dhe artistik për nxënësit e Komunës së Prizrenit
- Çasje e integruar dhe multisektoriale
- Kritere dhe transparencë në financim të aktiviteteve
- Bashkëpunim dhe bashkë-qeverisje me Shoqëri Civile
- Komunikim dhe bashkëpunim me donatorë, komunitetin ndërkombëtar dhe grupe të interesit

Për implementim të kësaj strategjie, parashihet një reformë në mënyrën e qeverisjes dhe buxhetimit të kulturës, e cila kërkon pjesëmarrjen e akterëve të ndryshëm komunal dhe të pavarur në planifikim kulturor. Duke qenë i ndërtuar si rezultat i një bashkëpunimi në mes të qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile dhe duke synuar një model të bashkëpunimit dhe bashkëqeverisjes në implementim, kjo strategji ofron një model të

ri dhe demokratik të qeverisjes, në përputhshmëri me modelet e avancuara europiane dhe ofron platformë konkrete për zhvillim të gjithëmbarshëm kulturor në Komunën e Prizrenit.

Strategjia e Kulturës 2017-2020 është ndërtuar mbi tri objektiva kyçe, që do të implementohen gradualisht në këtë periudhë katër-vjeçare. Ato janë: Rritja e pjesëmarrjes dhe çasjes në jetën kulturore, Zhvillimi i Turizmit kulturor dhe Ekonomisë kulturore dhe Reforma e qeverisjes së kulturës.

Objektiva e parë strategjike, synon rritjen e pjesëmarrjes dhe çasjes në jetën kulturore, për ta bërë kulturën të çashme për persona te grupeve të ndryshme sociale, komuniteteve etnike dhe të marginalizuara si dhe personave me nevoja te veçanta. Kjo objektivë synon orientimin e punës së institucioneve dhe organizatave të kulturës për të zhvilluar audienca të reja dhe promovuar konsumin kulturor. Objektiva do të arrihet përmes përkrahjes së festivaleve, aktiviteteve tradicionale kulturore dhe nismave të reja që synojnë rritjen e pjesëmarrjes në jetën kulturore, duke promovuar shfrytëzimin e hapësirave publike për aktivitete kulturore, duke ruajtur laramaninë kulturore dhe gjuhësore të Prizrenit, si dhe duke ofruar çasje fizike për PNV në institucionet dhe hapësirat kulturore.

Objektiva e dytë strategjike, synon Zhvillimit të Turizmit Kulturor dhe Ekonomisë Kulturore. Kjo komponentë parasheh krijimin dhe avansimin e mekanizmave për ruajtje, menaxhim dhe promovim të trashëgimisë kulturore, siç janë hartime të planeve të menaxhimit, ndërtim të njësive menaxhuese dhe planeve për promovimin dhe vet-qëndrueshmërinë e këtyre aseteve, hartimin e pakove të ndryshme për zhvillim të turizmit kulturor dhe të konferencave, rritjen e cilësisë së shërbimit në sektorin e hotelierisë, ndërtimin e një brendi dhe produkteve të qytetit të Prizrenit si dhe stimulimin e inovacionit dhe shfrytëzimit të artizanateve të vjetra.

Objektiva e tretë strategjike, është në shërbim të realizimit të këtyre dy objektivave kyçe dhe parasheh Reformë te qeverisjes së kulturës, ku propozohet ristrukturim institucional i sektorit të kulturës në komunë, përmes themelimit të Këshillit për Kulturë, ngritje të kapaciteteve menaxhuese dhe promovuese tek akterët dhe punëtorët e kulturës për ngritje të cilësisë dhe kapacitetit të gjithmbarshëm për qeverisje si dhe zhvillimit të politikave për edukim artistik dhe kulturor në shkolla fillore dhe të mesme, me qëllim të krijimit të gjeneratave të reja që marrin aktivisht pjesë në jetën kulturore dhe krijimtarinë artistike.

I.Hyrje

Strategjia e Kulturës 2017 - 2020

Strategjia e Kulturës 2017 - 2020 është hartuar si rezultat i bashkëpunimit të RrOK Prizren, Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe DKRS-së, në kuadër të projektit "Prioritizimi i Kulturës në Politikë-bërjen Lokale në Prizren", të përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe Zyra Zvicrane për Bashkëpunim në kuadër të projektit "Promovimi i Shoqërisë Demokratike" të menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile.

Në vazhdimësi të këtij projekti, janë realizuar aktivitete të ndryshme si punëtori, panele dhe debate, intervista dhe takime pune me palë, për definimin e objektivave dhe strukturës së strategjisë. Në proces kanë marrë pjesë akterë dhe udhëheqës nga Komuna e Prizrenit si Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Urbanizmit, Teatri Profesional i Prizrenit, Biblioteka Komonale e Prizrenit, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor, Agjensioni për Zhvillim Rajonal - Prizren, Info Qendra Turistike, si dhe organizata kulturore dhe anëtare të RrOK-ut si AKV Lidhja e Prizrenit, Autostrada Bienale, CHWB Kosova, DokuFest, Dogru Yol, Durmish Asllano, EC Ma Ndryshe, Fondacioni Lumbardhi, Paradigma, Sharski Behar, etj.

Metodologjia: Strategjia e kulturës dhe plani i veprimit 2017 - 2020¹

Metodologjia e hartimit të dokumenteve strategjike lokale është e harmonizuar me politikat dhe synimet nacionale, si dhe kornizën e integritit europian, sipas qasjes së Ciklit të Menaxhimit të Projektit, e cila ka për qëllim që të përcaktoj logjikën e intervenimit (prioritetet, qëllimet dhe masat) të programet dhe projektet dhe përcaktimin e vizionit dhe të misionit të përbashkët të të gjithë akterëve të cilët do të merren me zbatimin e tyre.

Përgatitja e strategjisë është bërë metodologjikisht në dy faza. Faza e parë përfshin një analizë të hollësishme të ambientit ligjor në sektorin e kulturës të komunës së Prizrenit, duke përfshirë gjendjen aktuale të financimit kulturor përmes buxhetit të qytetit dhe projektimin e financimit në periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2020, bazuar në rezultatet që kryen analizat e anëve të forta ee të dobëta dhe mundësive dhe përfitimeve (SWOT) për secilën fushë të trajtuar veq e veq.

¹ Strategjia është menduar si dokument i cili i adaptohet lehtë ndryshimeve dhe revidimeve të rregullta. Me rastin e revidimeve të strategjisë, ndonjëri nga caqet dhe masat mund të pësoj ndryshime në harmin me kontekstet e zhvillimeve, njohurive të reja dhe dukurive.

Faza e dytë përfshinë hartimin e dokumentit që ka filluar me përgatitjen e një analize të integruar duke vlerësuar dokumentet ekzistuese, anët e forta dhe të dobëta, mundësitë dhe përfitimet (SWOT), sipas së cilës është përcaktuar vizioni dhe misionin i zhvillimit kulturor të qytetit të Prizrenit dhe prioritetet, objektivat strategjike, masat dhe veprimet konkrete për të përmbushur këtë mision.

Strategjia e vendos modalitetin për bashkëpunim me faktorët e profilit institucional, të skenës së pavarur kulturore dhe të shoqërisë civile, si dhe nevojën për një përdorim më racional dhe efikas të burimeve për të arritur vizionin dhe misionin.

Kjo ndërmarrje e përbashkët e të gjithë akterëve lokal e ndërlidhë në mënyrë strategjike zhvillimin e planit kulturor të qytetit të Prizrenit, investimet e planifikuara, aktivitetet dhe iniciativat gjithëpërfshirëse, të menduara mirë dhe të qëndrueshme, të planifikuara në strategjinë e kulturës 2017 - 2020.

II. Analiza e gjendjes

Strategjia e Kulturës 2017 - 2020 e qytetit të Prizrenit filloi me një analizë të thuktë të sektorit të kulturës. Kjo analizë e detajizuar është zhvilluar në atë mënyrë që të përfshijë të gjitha segmentet e kësaj strategjie duke i vlerësuar të gjitha parakushtet historike, gjendjen e tanishme, rezultatet e hulumtimit dhe të projekcionit financiar. Kjo analizë gjithëpërfshirëse mund të përmblihet në një pasqyrë të bazuar në përparësitë dhe dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e sektorit kulturor të qytetit të Prizrenit.

2.1 SWOT Analiza

Përparësitë (S)	Dobësitë (W)
E kaluara interesante historike e pasur e qytetit	Integrimi i Kulturës dhe përpilimi i Strategjisë për Kulturë
Numri i madh i objekteve të trashëgimisë	Mungesa e infrastrukturës (vendngjarjet dhe hapësirat) dhe mosshfrytëzimi i lumit
Pozita atraktive gjeografike dhe destinacioni turistik	Neglizhenca e Artit dhe Artizanaleve
Numri i institucioneve kulturore	Komunikimi dhe Koordinimi në mes të akterëve
Numri i madh i ngjarjeve kulturore	Pjesëmarrja e ulët në jetën kulturore
Skena kulturore jo-formale, e fortë dhe aktive	Kultura = Festivalet
Numri i personaliteteve krijuese nga të gjitha fushat e kulturës dhe artit	Kultura & Edukimi i Arteve (mungesa e produkteve kulturore në shkolla)
Ngjarjet lokale të njohura në kontekstin rajonal, kombëtar dhe europian	Mungesa e hulumtimeve dhe storjes/narrativës për Prizrenin
Shumë-gjuhësia dhe shumë-besueshmëria	Mungesa e vizionit, stafit të kualifikuar dhe mekanizmave funksional për mbrojtje dhe menaxhim

<p>Trashëgimia Kulturore dhe Historike</p> <p>Organizimet Kulturore dhe Kalendari Kulturor</p>	
<p>Mundësitë (O)</p>	<p>Kërcenimet (T)</p>
<p>Disa hapësira të mundshme publike dhe zgjerimi i qytetit</p> <p>Kontakte ndërkombëtare / Rrjetëzime dhe hulumtim i donatorëve të ndryshëm</p> <p>Zhvillimi urban përmes kulturës</p> <p>Pasurimi i ofertës kulturore, turistike dhe oferta kulinare</p> <p>Rritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve të kulturës dhe shoqërisë civile</p> <p>Kultura - prioritet i politikave lokale</p> <p>Decentralizimi i menaxhimit të fondeve, bazuar në modele të sukseshme botërore dhe menaxhimi i integruar i qytetit</p> <p>Adaptimi i Agjenda 21 për Kulturë</p> <p>Potenciali i bashkëpunimit me Shkodër e Tiranë dhe rrjetëzimi me vende të ndryshme të ballkanit dhe jetësimi i raportit me qytete binjake</p>	<p>Mungesa e edukimit kulturor</p> <p>Ekonomia e pa balancuar dhe ndikimi politik për zhvillim të kulturës</p> <p>Interesat e sektorit të ndërtimit të pasurive të patundshme dhe jo kontrollimi i spekulimeve urbane të pasurive të patundshme</p> <p>Përkeqësimi i trashëgimisë kulturore e historike dhe dëmtimi i vlerave të trashëgimisë kulturore</p> <p>Shkatërrimi i vazhdueshëm i monumenteve historike dhe mungesa e planeve të menaxhimit të monumneteve të TK</p> <p>Mungesa e vëmendjes në nivel qendror</p>

2.2 Vështrim mbi gjendjen e sektorinit të kulturës në komunën e Prizrenit

Modeli kulturor aktual

Për vite, sektori i kulturës është trajtuar si përgjegjësi e një drejtorie, përkatësisht një njësie brenda asaj drejtorie dhe buxheti është ndarë për subvencionimin e disa aktiviteteve kulturore dhe projekte të investimit kapital. Ky model që e sheh kulturën vetëm si një listë e ngjarjeve kulturore dhe ndërtime të objekteve kulturore është dëshmuar i pamjaftueshëm për qasje të integruar (komunikim me sektorët tjerë) dhe ka dëshmi të kufizuara të ndikimit pozitiv.

Sektori në përgjithësi

Kultura në Prizren administrohet nga ana e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport por përfshin shumë akterë dhe trupa të ndryshëm që kanë për mandat të përgjithshëm të zhvillimit të jetës kulturore. Teatri Profesional i Qytetit, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore, Këshilli për Qendrën Historike dhe Biblioteka e Qytetit janë vetëm disa nga institucionet që luajnë rol kyç në zhvillim të jetës kulturore. Në anën tjetër, Prizreni posedon një skenë të avansuar kulturore si rezultat i punës së organizatave kulturore dhe shoqërive kulturo-artistike, të cilat e pasurojnë kalendarin kulturor dhe e mbajnë të gjallë jetën kulturore në qytet.

Sidoqoftë, në të gjitha instancat akterët kanë nenvizuar faktin që ka problem në komunikim dhe koordinim nderinstitucional dhe që në përgjithësi ekziston gadishmëria për bashkëpunim në mes të akterëve. Në anën tjetër, është vërejtur që nuk ekziston ndonje vizion i qartë për kulturë, apo orientim në nivel të politikave të definuara. Me këtë qëllim, hulumtimi është zgjeruar dhe iu është çasur shumë akterëve, mbi të cilat është ndërtuar themeli i strategjisë.

Në anën tjetër, për bazë janë marrë orientimet strategjike të Komunës së Prizrenit, Rajonit Jugor si dhe dokumentet tjera të rëndësishme të nivelit kombëtar që i përcaktojnë prioritetet dhe planet për këtë zonë.

2.3. Përmbledhje e Dokumenteve Relevante Ekzistuese Strategjike Lokale dhe Qendrore

Ky dokument është hartuar në harmoni me planet ekzistuese strategjike dhe rajonale të Komunës dhe Rajonit të Prizrenit, sikurse edhe të nivelit kombëtar. Vizioni dhe orientimet e dokumentit janë definuar në përputhshmëri me këto plane ekzistuese.

Vizioni për ardhmërinë e Komunës së Prizrenit

“Të zhvillohet Prizreni si një qendër e qëndrueshme kulturore në Kosovë dhe Ballkan, duke promovuar potencialin e tij sa i përket aseteve historike, resurset natyrore dhe ambientale, diversitet social dhe vitalitet ekonomik ” (Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2025)

Plani Hapësinor i Kosovës dhe Ardhmëria e Komunës së Prizrenit

Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ i përpiluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vitin 2010 propozon katër zona/regjione ku Prizreni është qendër e Kopshteve të Kosovës. Kjo zonë është paraparë për turizmin kulturor, industrinë bujqësore dhe tregti dhe shërbime ku Prizreni ka një rol udhëheqës me potencialin e saj rekreativ dhe kulturor si dhe vlerat natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore. Vizioni për Prizrenin në bazë të këtij plani është ndërtimi i qendrës në rrënjët tradicionale të kësaj treve antike, të shndërrohet në një qendër moderne kulturore-turistike të zhvilluar në një rrjet funksional duke krijuar lidhje më të forta me fshatrat rurale për të stimuluar aktivitetet e bazuara në potencialet natyrore dhe atraktive për të punuar dhe jetuar aty dhe hapësirë të mjaftueshme për kyçjen e sektorit privat në vreshtari, bujqësi dhe turizëm. Plani po ashtu sugjeron krijimin e ambientit tërheqës për zhvillimin e aktiviteteve private afariste dhe inkurajon shfrytëzimin më të mirë të potencialeve lokale ekonomike si dhe të burimeve njerëzore e natyrore, sidomos në turizëm dhe bujqësi.

Qëllimet e përgjithshme për Prizrenin të caktuara në Plan janë:

- Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike,
- Qeverisja dhe administrata efikase që mbështet qëllimet zhvillimore,
- Programi për zhvillimin lokal ekonomik përmes promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,
- Zhvillimi i kultivimit të frutave, vreshtarisë dhe bujqësisë,
- Zhvillimi i turizmit malor dhe atij kulturor, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore.

Sidomos konsiderata e trashëgimisë kulturore në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm dhe strategjisë së konservimit (ruajtjes) të vendit. Në këtë aspekt, Prizreni është një nyje e rëndësishme me trashëgiminë e saj të pasur historike dhe kulturore si dhe me resurse mjedisore. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ e përcakton rolin e Prizrenit si “Qytet Muze” për të kontribuar në krijimin e kushteve për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë për zhvillimin lokal ekonomik. Por duke u nisur nga strategjia, ka nevojë për një veprim të përqendruar në aspektin e mbrojtjes ambientale dhe të burimeve njerëzore, si dhe për promovim të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, mbrojtjen e cilësisë së tokës bujqësore dhe promovimin e prodhimeve vendore, mbrojtje të resurseve minerale dhe përdorimin racional të tyre si dhe kontrollimin e rritjes së vendbanimeve.

Vizioni i Integruar i Prizrenit

Vizioni i integruar i Prizrenit i përgatitur nga Komuna e Prizrenit dhe UN HABITAT në Mars të vitit 2008 përcjellë vizionin e përcaktuar në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ dhe Prizreni definohet si: “**qendra e trashëgimisë kulturore dhe natyrore**,, me një ekonomi që krijon potenciale për zhvillimin e shoqërisë si dhe udhëkryq i regjionit ku sundon toleranca dhe ligji”

Ajo është strukturuar në pesë fusha themelore të intervenimit sa i përket zhvillimit komunal. Këto fusha janë:

- Zhvillimi urban, rural dhe Planifikimi
- Lëvizshmëria dhe Transporti
- Trashëgimia Kulturore dhe Burimet Natyrore
- Ambienti Ekonomik dhe Bujqësia
- Infrastruktura dhe Shërbimet Publike.

Plani Zhvillimor Urban i Prizrenit

Plani Zhvillimor Urban i Prizrenit që është përgatitur nga Komuna e Prizrenit më 2003 dhe paraqet një plan dhjetë vjeçar për zhvillimin e qëndrueshëm të qendrës së Prizrenit. Ky plan nuk ka një vizion të qartë për ardhmërinë e Komunës së Prizrenit. Plani nënvizon rëndësinë e madhe të trashëgimisë kulturore dhe historike të Prizrenit. Ruajtja dhe integrimi i ndërtesave dhe komplekseve ndërtimore me vlera historike dhe kulturore në zhvillimet bashkëkohore kanë rolin e madh në zhvillimin e përhershëm. Trashëgimia e mbrojtur do të paraqes një përbërës të rëndësishëm të pamjes së përgjithshme të qytetit. Të gjitha vlerat trashëgimore duhet të rigjenerohen. Qëllimi i këtij regjenerimi është arritja e vlerave që do të ballafaqohet me ndryshimet kohore. Trashëgimia kulturore dhe historike janë potencial për zhvillimin ekonomik. Promovimi i këtyre vlerave paraqet trendin zhvillimor të sektorit të turizmit.

Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2025

(Vizioni për Prizrenin): Prizreni pritet të ketë pozitë qendrore si qendër moderne kulturore turistike përmes rrjetit funksional që krijon lidhje më të forta me fshatrat rurale. Rezultatet e pyetësorit nga debati publik PZHKP 2025 po ashtu sugjerojnë rolin e ardhshëm të Prizrenit si qendër kulturore që përdor trashëgiminë e saj të pasur kulturore dhe natyrore.

Komuna e Prizrenit posedon një sërë forcash shtytëse siç është prezantuar në fazën e parë të PZHKP 2025. Ato janë:

- Trashëgimia e pasur kulturore dhe natyrore
- Resurset e pasura / të volitshme mjedisore
- Diversiteti socio - kulturor
- Fuqia punëtore e re, e edukuar dhe e kualifikuar

- Potenciali i lartë bujqësor dhe prodhues
- Linja të mira transportuese me pjesët tjera të Kosovës dhe shtetet fqinje

Parimet kyçe të PZHKP 2025 janë:

- Parimi 1: Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Parimi 2: Qëndrueshmëria ambientale
- Parimi 3: Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë jetësore
- Parimi 4: Vitaliteti ekonomik
- Parimi 5: Integriteti hapësinor

Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike

Objektivat themelore të Planit të Konservimit janë grupuar në këto kategori: Kualifikimi Funksional, Komunikimi Optimal, Integrimi shoqëror dhe kulturor, Mjedis pozitiv për kualitetin arkitektonik dhe urban, Kushte pozitive për shëndet dhe qetësi, Çmimi optimal dhe përkrahja ekonomike, Flaksibiliteti dhe zbatueshmëria.

Objektivat e kategorisë “Integrimi shoqëror dhe kulturor” janë:

- Të bëhet transformimi i një nga vendet më të rëndësishme të Kosovës përsëri në një qendër atraktive kulturore e turistike, duke lartësuar vlerat kulturore, arkeologjike dhe natyrore, si dhe potencialin e trashëgimisë arkitektonike dhe strukturën tradicionale urbane që e posedon,
- Të ngritët vetëdija publike mbi konservimin e trashëgimisë kulturore duke siguruar një ambient edukativ,
- Të rritët kuptimin e planit të konservimit në mënyrë që të siguroj zhvillimin e strukturave shoqërore,
- Të tërheqë vëmendje në konservim, planifikim dhe procesin e tij të implementimit me pjesëmarrjen e plotë të banorëve.

Idea e përgjithshme e njerëzve është që të vlerësohen tiparet historike të zonës me anë të organizimeve të ndryshme në Prizren. Shumica e njerëzve kanë deklaruar se ata e imagjinojnë vendin të shfrytëzohet për qëllime turistike dhe mendojnë se shumica e shtëpive të listuara duhet të restaurohen dhe të shfrytëzohen si hotele, restorante dhe përmbajtje të ngjashme. Njerëzit kanë nevojë për një mjedis me më shumë vende për këmbësorë dhe se Prizreni duhet të zhvillohet duke marrë parasysh potencialin turistik dhe kulturor.

KK i Prizrenit ndien nevojën për plane të detajizuara të këtij lloji si dhe projekt-propozime duke pasur parasysh që një ndër komponentet kryesore për zhvillim ekonomik të Komunës së Prizrenit është edhe turizmi dhe zhvillimi i tij duke e shfrytëzuar trashëgiminë kulturore dhe revitalizimin e objekteve me vlera, monumenteve, shesheve, krijimin e ansambleve me vlera si dhe revitalizimin e atyre ekzistuese dhe aktiviteteve kulturore që mund të zhvillohen duke pasur parasysh karakterin e zonës.

Strategjia orientuese për zhvillimin kulturor në Komunën e Prizrenit 2012 – 2016

Falë infrastrukturës së instaluar kulturore, e cila përqipet të jetë në funksion të ruajtjes, kultivimit dhe prezantimit të vlerave të trashëgimisë së kulturës materiale e shpirtërore, qyteti i Prizrenit provon të projektojë edhe në zhvillimin e turizmit, si veprimtari ekonomike profitabile. Prizreni ka një potencial të lakmueshëm vlerash kulturore të trashëguara nga periudha të ndryshme historike.

Me 24 lokalitete arkeologjike të identifikuar, me 39 objekte kulti të krishtera, 46 objekte sakrale islame, me mbi 74 objekte me karakteristika të theksuara të arkitekturës folklorike, Prizreni synon të bëhet një qendër e frekuentuar turistike. Kalaja që ngrihet në kodrën mbi qytet, Kisha e Shën Premtes, Manastiri i Kryeengujve, Kisha e Shën Shpëtimtarit, Katedralja e Zonjës Ndhimëtare, Xhamia e Sinan Pashës, Hamami i Gazi-Mehmet Pashës, Ura e Vjetër e Gurit, janë vetëm një pjesë e trashëgimisë së kulturës materiale që mund të hasen në qytetin e Prizrenit.

Prizreni është i njohur edhe për traditën e mirë të kultivimit të arteve të bukura. Në te janë organizuar dhe vazhdojnë të organizohen manifestime të shumta kulturore tradicionale. Festivali i këngës së vjetër qytetare “Zambaku i Prizrenit”, Festivali i filmit dokumentar të shkurtër “Dokufest”, fillimi i mbarë i punës së Teatrit Profesionist të qytetit dhe një varg ngjarjesh tjera kulturore të karakterit kombëtar e ndërkombëtar, që bëjnë Prizrenin edhe më joshës në planin turistik. Kur të gjitha këtyre u shtohen edhe bukuritë e rralla natyrore të Maleve të Sharrit me qendrën e njohur skitare, me të drejtë mund të thuhet se **“mozaiku i kërkesave turistike”** plotësohet në tërësi.

Kjo Strategji Orientuese po ashtu kishte propozuar modelin e "Këshillit për Kulturë" si metodë më efektive të planifikimit dhe qeverisjes së kulturës në nivel komunal.

Strategjia e zhvillimit dhe e marketingut turistik për rajonin jugor të Kosovës 2012 – 2020 (ASB)

Prizreni do të vazhdojë të jetë tërheqës kryesisht për turistët të cilët dëshirojnë të përjetojnë hotelet, bujtinat dhe llojet e tjera të hoteleve familjare, së bashku me evenimentet e tjera që ofron ky qytet. Me një rritje të numrit të turistëve të Rajonit, sfida kryesore për të ardhmen mbetet përmirësimi i pamjes dhe i atraktivitetit të qendrës së këtij qyteti duke ruajtur me fanatizëm karakterin tradicional. Për këtë arsye, duhen përgatitur studime fizibiliteti për restaurimin e jashtëm dhe meremetimin e shtëpive dhe të objekteve historike dhe tregtare të cilat kanë pamje më të dukshme.

Inkurajimi i zhvillimit të rrjetit tregtar me atë të kateringut, duhet konsideruar prioritet për komunën në të ardhmen. Gjithashtu, promovimi më i mirë i monumenteve kulturore të cilat mund të kombinohen me shëtitje me pajton, ture nëpër qytet është esencial për të tërhequr më shumë vizitorë në të ardhmen. Rivitalizimi i tyre, i mbështetur nga guidat lokale, së bashku me prezencën e projekteve të ndryshme artizanale dhe të suvenireve, si dhe organizimi i evenimenteve të ndryshme kulturore do të përbënin apele të fuqishme për turistët në të ardhmen.

III. ÇKA NA SJELLË STRATEGJIA E KULTURËS 2017 – 2020?

Modeli kulturor i propozuar

Modeli i qeverisjes kulturore që propozon ky dokument strategjik e integron kulturën në të gjitha sferat dhe dimensionet e qeverisjes lokale, duke e ngritur në prioritet të politikave publike. Modeli i propozuar parasheh reformë institucionale dhe ndryshim të mendësisë së buxhetimit të kulturës. Përveç që krijon lidhje të drejtpërdrejta në mes të kulturës dhe agjendës së zhvillimit ekonomik të qytetit, ky model siguron edhe mobilizim alternativ fondesh dhe ndërkombëtarizim të qytetit përmes artit dhe kulturës.

Zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal

Kjo strategji është hartuar në përputhje me të gjeturat (resurset dhe potencialet), parimet dhe objektivat zhvillimorë që përcaktohen nga Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit. Dokumenti synon të operacionalizojë zotimet e komunës për zhvillim ekonomik përmes kulturës, turizmit, trashëgimisë kulturore dhe natyrës. Ky dokument strategjik, esencialisht përdor çasjen “kulturë për zhvillim ekonomik” dhe është në përputhje me modelet aktuale të qeverisjes lokale kulturore në botë.

Në vend të subvencionimit: Konkurse dhe grante

Subvencionimi si praktikë e deritanishme e përkrahjes së ngjarjeve kulturore nuk është praktika më e mirë për zhvillim kulturor. Strategjia parasheh krijimin e linjave të veçanta për përkrahjen e organizatave të pavarura të kulturës (dhe artistëve individual) dhe rekomandon që shpërndarja e këtyre mjeteve (grantet për projekte dhe grante institucionale) të bëhet përmes konkurseve të rregullta publike.

Këshilli për Kulturë

Për të menaxhuar në mënyrë efikase këto ndryshime dhe masa, një njësi marginale brenda një drejtorie nuk do të jetë e mjaftueshme. Për këtë arsye, ky dokument strategjik parasheh shuarjen e njësisë së kulturës brenda Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe themelimin e Këshillit Kulturor të Prizrenit, në kuadër të kabinetit të Kryetarit të Komunës. Pjesë e Këshillit do të jenë përfaqësues të drejtorive përkatëse, organizatave të skenës së pavarur kulturore dhe grupeve tjera të interesit dhe komunitetit. Këshilli do të ketë për mandat qeverisjen kulturore të komunës, ndërsa dokumenti bazë i punës së Këshillit do të jetë Strategjia Komunale e Kulturës.

Ngritja e Kulturës në prioritet

Themelimi i Këshillit për Kulturë dhe vendosja e kësaj njësie menaxhuese të kulturës në Kabinetin e Kryetarit të Komunës, nënkupton ngritje të kulturës në prioritet të politikave publike. Kjo strategji synon të instalojë traditën e qeverisjes dhe zhvillimit lokal të bazuar në kulturë, duke i nxitur kryetarët e komunës për qeverisje me ndieshmëri të lartë ndaj kulturës, si aseti më i rëndësishëm ekonomik dhe social i Prizrenit.

Buxhetimi i integruar

Për të siguruar komplementaritet në mes të kulturës dhe sferave tjera të politikave dhe sidomos agjendës së zhvillimit ekonomik, strategjia propozon një qasje të integruar të buxhetimit të kulturës. Të gjitha veprimet që lidhen me zbatimin e kësaj strategjie dhe të tjera në fushën e kulturës duhet të buxhetohen brenda drejtorive përkatëse, përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie. Këshilli Artistik do të jetë përgjegjës për menaxhimin e buxhetit të kulturës në koordinim me të gjitha drejtoritë që janë pjesë e menaxhimit kulturor.

Mobilizimi i fondeve nga palët e treta

Logjika e buxhetimit e këtij dokumenti synon të mos e ngarkojë buxhetin publik të Prizrenit në masë të madhe, por propozon rrugë alternative për mobilizim të fondeve. Rol të rëndësishëm në mobilizimin e fondeve shtesë për realizimin e kësaj strategjie do të luajnë organizatat e shoqërisë civile duke qenë të përfshirë në mënyrë direkte në zbatimin e kësaj strategjie.

Bashkëqeverisje me shoqërinë civile

I gjithë procesi i hartimit të këtij dokumenti është menaxhuar nga Rrjeti i Organizatave të Kulturës nën koordinimin e Fondacionit Lumbardhi. Masat dhe veprimet e parapara brenda 3 objektivave të këtij dokumenti strategjik janë në përputhje edhe me punën dhe angazhimet e organizatave të pavarura të kulturës në Prizren. Një pjesë e obligimeve që dalin nga kjo strategji do të përmbushen nga vetë organizatat e shoqërisë civile, ndërsa përmes Këshillit për Kulturë që do të ketë përbërje të përzier, shoqëria civile do të bëhet pjesë integrale e qeverisjes në kulturë për realizimin e veprimeve të parapara me këtë strategji.

Agjenda 21 për Kulturën

Miratimi i kësaj strategjie dhe themelimi i Këshillit për Kulturë janë dy nga katër parakushtet themelore për anëtarësimin e komunës së Prizrenit në nismën globale të qyteteve Agjenda 21 për Kulturën. Nëse arrihet kjo, Prizreni do të jetë komuna e parë në Kosovë që anëtarësohet në nismën më të madhe globale të qyteteve për kulturë, duke e siguruar edhe një mundësi të ndërkombëtarizimit dhe mobilizimit të fondeve shtesë për zbatimin e kësaj strategjie.

IV. Vizioni, Misioni dhe Objektivat

Vizioni

“Të zhvillohet Prizreni si një qendër e qëndrueshme kulturore në Kosovë dhe Ballkan, duke promovuar potencialin e tij sa i përket aseteve historike, resurset natyrore dhe ambientale, diversitet social dhe vitalitet ekonomik” (Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2025)

Qyteti ka një vizion të definuar mirë në Planin Zhvillimor Komunal dhe synimi i Strategjisë së Kulturës është që të kontribuon në këtë vizion me definim të misionit dhe objektive të caktuara.

Misioni

Vizionin e tij në fushën e kulturës Prizreni do ta arrijë duke siguruar zhvillimin e kushteve themelore financiare, organizative, infrastrukturore, ligjore dhe materiale, të nevojshme për zbatimin e strategjisë.

Misioni i Strategjisë për Kulturë është "Kultura - prioritet dhe shtyllë e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, me qeverisje të integruar dhe demokratike dhe e çasshme për të gjithë".

Me implementim të suksesshëm të këtij misioni, Prizreni deri në vitin 2020 do ta ketë arritur integrimin jetësor, krijues, dhe punues, në një ambient tolerant dhe të mundësive të ndryshme, me ndërveprim të komuniteteve dhe akterëve të ndryshëm, duke e shëndruar kulturën në një nga shtyllat e prosperitetit social dhe ekonomik për të gjitha kategoritë e popullsisë. Edukimi kulturor në shkolla dhe aktivitete jashta-shkollore, do të kontribuojnë në ndërtimin e një rinie më tolerante, që e respekton diversitetin e qytetit, e njeh trashëgiminë kulturore dhe historike të qytetit, merr pjesë në aktivitete kulturore dhe prodhon jetë kulturore. Ndërsa në nivel ekonomik, turizmi në qytetin e Prizrenit shëndrohet në veprimtari që shtrihet në mbarë vitin, me oferta më cilësore që e zhvillojnë ekonominë lokale, përdërisa aktivitetet kulturore në vete dhe prodhimitaria artizanale, e dizajnit dhe produkteve tjera lokale, do të ndikoj në krijimin e vendeve të punës dhe ngritje të mirëqenies socio-ekonomike.

Strategjia kontribuon direkt në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës kulturore, ofron hapësirë për krijimin e praktikave të reja kulturore përmes shprehive arsimo-edukative dhe artistike. Kujdesi për kulturën dhe artin ndër të tjera përfshin aktivitetet që lidhen me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e objekteve kulturore si dhe promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Prizrenit.

Sistemi i objektivave strategjike

Qyteti i Prizrenit misionin e tij të zhvillimit të kulturës do ta ushtrojë përmes zbatimit të tri objektivave strategjike dhe masave të tyre përcjellëse, sipas logjikës së intervenimit:

Objektiva strategjike I: Rritja e pjesëmarrjes dhe çasjes në jetën kulturore

Objektiva e parë strategjike, synon rritjen e pjesëmarrjes dhe çasjes në jetën kulturore, për ta bërë kulturën të çasshme për persona të grupeve të ndryshme sociale, komuniteteve etnike të marginalizuara si dhe personave me nevoja të veçanta. Kjo objektivë synon orientimin e punës së institucioneve dhe organizatave të kultures për të zhvilluar audienca të reja dhe promovuar konsumin kulturor. Objektiva do të arrihet përmes përkrahjes së festivaleve, aktiviteteve tradicionale kulturore dhe nismave të reja që synojnë rritjen e pjesëmarrjes në jetën kulturore, duke promovuar shfrytëzimin e hapësirave publike për aktivitete kulturore, duke ruajtur laramaninë kulturore dhe gjuhësore të Prizrenit si dhe duke ofruar çasje fizike për PNV në institucionet dhe hapësirat kulturore.

Arritja e këtij objektivi synohet të bëhet përmes ndarjes së kodit buxhetor dhe themelimit të fondit për skenën e pavarur, që ka për synim arritjen e objektivave të kësaj strategjie, sic janë: rritja e pjesëmarrjes në jetën kulturore, krijimi i audiencave të reja, ruajtja e laramanisë kulturore dhe gjuhësore të Prizrenit dhe promovimi i artit në hapësirë publike.

1.1 Përkrahja e festivaleve dhe aktiviteteve tjera tradicionale që ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes në jetën kulturore: Iniciativat lokale, festivalet, aktivitetet tradicionale dhe organizatat tjera kulturore, përkrahjen e marrin sipas përmbushjes së kriterëve dhe politikave të caktuara nga Komuna e Prizrenit përmes kësaj strategjie. Ky fond mundësohet nga linja e subvencioneve të drejtorive të ndryshme relevante si DKRS, DKA, DUPH, DTZhe dhe DShP, ndërsa shpërndahet me konkurs të hapur publik, me kriterë të caktuara dhe me vlerësim të komisioneve profesionale që përcaktohen nga këshilli. Në këtë mënyrë arrihet financimi transparent, vlerësimi cilësor si dhe mekanizëm i qartë i mënyrës së shpërndarjes së parasë publike.

1.2 Shfrytëzimi i hapësirave publike për rritjen e çasjes në aktivitete kulturore: Për arritjen e këtij objektivi duhet të bëhet identifikimi i hapësirave publike të shfrytëzueshme për art në hapësirë publike, koncerte, performanca dhe aktivitete tjera kulturore. Parashihet të sigurohet mirëmbajtja e këtyre hapësirave publike, si dhe nxitja e organizimit të aktiviteteve që mund të mbahen në këto hapësira, përmes Fondit për Skenën e Pavarur. Politikat e artit në hapësirë publike caktohen nga Këshilli për Kulturë dhe sipas kriterëve, hapen konkurse për intervenime të përkohshme në hapësira publike, të cilat vlerësohen nga komisione profesionale dhe përzgjedhen pas diskutimeve publike me qytetarë.

Në kuadër të kësaj shtyllë të strategjisë, po ashtu hartohet dhe përditësohet një kalendar kulturor online, i cili e njofton publikun për aktivitetet e organizuara nga institucionet kulturore të qytetit, organizatat, si dhe ngjarjet tjera kulturore që ndodhin në qytet. Në vend të kalendarit të shtypur, ky produkt siguron mundësinë e përditësimit dhe vendosjes së aktiviteteve në mënyrë më dinamike dhe i informon qytetarët, turistët dhe të gjithë të interesuarit mbi aktivitetet që ndodhin në komunë të Prizrenit të cilat gjenden të përqëndruara në platformën online.

1.3 Ruajtja e laramanisë kulturore dhe e gjuhëve të Prizrenit: Kjo masë parasheh që në afat të mesëm të dokumentohet diversiteti kulturor dhe gjuhësor në komunën e Prizrenit, përmes projekteve të historisë gojore, tregimeve, arkivave pamore e materiale si dhe aktiviteteve të ndryshme, me qëllim të ruajtjes së kujtesës kolektive të qytetit, ndërtimit të tregimit dhe brendit të qytetit, por edhe vlerësimit të njërës prej pasurive kryesore të Prizrenit, që atë e bëjnë atraktiv për qytetarët e vet dhe vizitorët.

Dokumentimi i diversitetit është po ashtu i rëndësishëm për përfshirjen sociale të komuniteteve dhe sigurimin e ndërveprimit në mes tyre, dhe arritjen e një kohezioni social. Dokumentet po ashtu shërbejnë për zhvillimin e lëndëve shkollore për gjuhën dhe kulturën e komuniteteve në komunën e Prizrenit. Në bashkëpunim me Universitetin e Prizrenit dhe të Prishtinës, institucione të ndryshme akademike të vendit dhe jashtë vendit, mbështesin hulumtimet shkencore që e dokumentojnë diversitetin kulturor të Prizrenit.

1.4. Krijimi i çasjes fizike për PNV: Një prej elementeve më të rëndësishme të sigurimit të çasjes në jetën publike kulturore është krijimi i çasjes fizike për PNV. Kjo masë përfshin çasjen në institucione kulturore, monumente të trashëgimisë, shkolla dhe hapësira publike në përgjithësi. Kjo është komponente e rëndësishme dhe prioritet i secilit nivel të qeverisjes dhe është angazhim për sigurimin e një të drejtë themelore të njeriut.

Objektiva strategjike II: Zhvillimi i Turizmit kulturor dhe Ekonomisë Kulturore

Objektiva e dytë strategjike, synon Zhvillimin e Turizmit Kulturor dhe Ekonomisë Kulturore. Kjo komponentë parasheh krijimin dhe avansimin e mekanizmave për ruajtje, menaxhim dhe promovim të trashëgimisë kulturore siç janë: hartime të planeve të menaxhimit, ndërtim të njësive menaxhuese dhe planeve për promovimin dhe vet-qëndrueshmërinë e këtyre aseteve, hartimin e pakove të ndryshme për zhvillim të turizmit kulturor dhe të konferencave, rritjen e cilësisë së shërbimit në sektorin e hotelierisë, ndërtimin e një brendi dhe produkteve të qytetit të Prizrenit, si dhe stimulimin e inovacionit dhe shfrytëzimit të artizanateve të vjetra.

2.1. Ruajtja, menaxhimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore: Masa e parë synon krijimin e një sistemi të ruajtjes, menaxhimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore. Njëra ndër veprimet kryesore është Hartimi i Planit të Menaxhimit të Konservimit të Qendrës Historike, i cili i përcakton detyrat e zyrës për qendrën historike si dhe vizionin dhe objektivat zhvillimore të Qendrës Historike të Prizrenit. Në kuadër të

kësaj mase, bëhet inventarizimi i kujtesës kolektive njashtu mbështeten publikimet me karakter promovimi të trashëgimisë kulturore të Prizrenit.

2.2 Zhvillimi dhe promovimi i turizmit kulturor: Për arritjen e kësaj mase parashihet krijimi i pakove turistike të zhvilluara në bashkëpunim me operatorë turistik si dhe krijimi i kushteve dhe ofertave për promovim të turizmit. Duke mundësuar adaptimin e disa prej hapësirave publike, atyre kulturore dhe monumenteve të trashëgimisë për punëtori, konferenca dhe aktivitete të ngjashme duke krijuar pako me oferta, mund të casen bizneset, odat e avokatëve, mjekëve, institucionet dhe entitete të ndryshme nga vendi dhe rajoni, që ti zhvillojnë aktivitetet e tyre në Prizren. Në mbështetje të kësaj komponente parashihet edhe aktivizimi i inspektionit sanitary si dhe vendosja e standardeve për hotelieri, sikurse edhe organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve tjera për ngritje të kapaciteteve dhe rritje të cilësisë në shërbime.

2.3 Brendimi i qytetit të Prizrenit është një masë e rëndësishme e këtij plani dhe përfshin identitetin pamor, brendin, produktet, reklamat dhe të gjithë marketingun e qytetit që del si produkt i një procesi të hapur multisektorial. Duke inventarizuar produkte të ndryshme me mundësi brendimi të qytetit dhe produkteve lokale (për ilustrim: Shadërvani, Ura e Gurit, Ajvari, Djathi i Sharrit, Pitajkat e Ramazanit), krijohet një "brend-book" i cili qarkullohet me komunitetin lokal të biznesit dhe me gjerë dhe synon harmonizimin vizuel të qendrës historike dhe vendeve të ndryshme të qytetit. Ndërtimi i brendit po ashtu lidhet me reklama direkte apo indirekte në media të huaja, web-faqe për turizëm dhe platforma të ndryshme online dhe offline që mund ta rrisin sasinë e turistëve.

2.4.Stimulimi i ringjalljes së artizanateve të vjetra: Kjo masë përbëhet nga identifikimi i artizanatave të vjetra dhe kujtesës kolektive për to. Ky dokumentim shërben për ruajtje të kujtesës kolektive, prodhim të materialeve promovuese por edhe konstatim të gjendjes së këtyre zanateve. Me identifikimin e zanatave që kanë mundësi adaptimi në mjedisin e ri ekonomik, synohet të krijohen mënyra të reja dhe inovative për ringjalljen e atyre, ku me dizajne të reja prodhohen brendet e produkteve të Prizrenit por edhe porosi tjera.

Objektiva strategjike III: Reforma e qeverisjes së kulturës

Objektiva e tretë strategjike, është në shërbim të realizimit të këtyre dy objektivave kyqe dhe parasheh Reformë te qeverisjes së kulturës, ku propozohet ristrukturim institucional i sektorit të kulturës në komunë, përmes themelimit të Këshillit për Kulturë, ngritje të kapaciteteve menaxhuese dhe promovuese tek akterët dhe punëtorët e kulturës për ngritje të cilësisë dhe kapacitetit të gjithëmbarshtëm për qeverisje si dhe zhvillimit të politikave për edukim artistik dhe kulturor në shkolla fillore dhe të mesme, me qëllim të krijimit të gjeneratave të reja që marrin pjesë aktivisht.

3.1. Ristrukturimi institucional i sektorit të kulturës në komunë: Për t'i menaxhuar në mënyrë efikase këto ndryshime dhe masa, një njësi marginale brenda një drejtorie nuk do të jetë e mjaftueshme. Për këtë arsye, ky dokument strategjik parasheh ristrukturimin e qeverisjes së kulturës, me themelimin e Këshillit Kulturor të Prizrenit, në kuadër të kabinetit të Kryetarit të Komunës. Pjesë e Këshillit do të jenë përfaqësues të drejtorive përkatëse, organizatave të skenës së pavarur kulturore dhe grupeve tjera të interesit dhe komunitetit. Këshilli do të ketë për mandat qeverisjen kulturore të komunës, ndërsa dokumenti bazë i punës së Këshillit do të jetë Strategjia Komunale e Kulturës. Pas miratimit të strategjisë, përmes një grupi të emëruar nga Komuna e Prizrenit, definohen përgjegjësitë e këshillit, termat e referencës, mandati, mënyra e përzgjedhjes, përbërja dhe të gjitha detajet tjera të rëndësishme, të cilat pastaj kthehen në një diskutim tjetër publik, para se të fillohet me implementim të reformave.

3.2. Konsolidimi i shkathtësive menaxheriale të akterëve të kulturës për çasjen e re në menaxhim kulturor: Për arritjen e këtyre masave ekziston nevoja e ngritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe organizative në sektorin e gjerë të kulturës në Prizren. Prej hotelierisë, deri te menaxherët e komunikimit, ciceronët dhe shërbyesit tjerë që punojnë në sektor, duhet të njihen me çasjen e re në menaxhim por edhe të aftësohen me disa prej trendeve të rëndësishme europiane dhe globale. Këshilli në bashkëpunim me Universitetin e Prizrenit dhe programe të ndryshme të Menaxhimit të Kulturës, do të kontribuojnë në këtë proces.

3.3. Edukim artistik dhe kulturor në shkollat fillore dhe të mesme të komunës: Edukimi artistik dhe kulturor në shkollat fillore dhe të mesme është një masë shumë e rëndësishme e kësaj strategjie dhe i paraprinë Strategjisë Kombëtare për Edukim Artistik që është në hartim e sipër nga MKRS dhe MASHT. Kjo masë synon rritjen e pjesëmarrjes aktive të rinjve në jetën kulturore, t'i shëndrojnë rinjtë në krijues aktiv të jetës kulturore dhe ta promovojë edukimin kulturor dhe artistik tek organizatat dhe institucionet publike të kulturës. Kjo masë kërkon një bashkëpunim të ngushtë me DKA-në dhe me MASHT si dhe me entitetet lokale si QRTK, Biblioteka Komunale, Teatri Profesional, organizatat kulturore dhe grupe të ndryshme që mund të ofrojnë aktivitete ekstrakurikulare kulturore për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme.

IV. Metodologjia e zbatimit të strategjisë

Pas miratimit të Strategjisë në asamble, kryhen këshillimet e nevojshme ligjore për ri-formatim të qeverisjes së kulturës dhe ndjeken procedurat përkatëse që çojnë drejt themelimit të këshillit. Në ndërkohë, grupi i caktuar nga Komuna e Prizrenit i definon parametrat dhe kriteret për Këshillin për Kulturë, i cili i cakton mekanizmat e raportimit dhe monitorimit të miratuara nga Kryetari i Komunës.

Arritjet e objektivave dhe masave të caktuara me këtë strategji monitorohen sipas sistemit të mëposhtëm të objektivave strategjike.

Objektiva strategjike I: Rritja e pjesëmarrjes dhe çasjes në jetën kulturore

Masat	Veprimet	Treguesit	Burimet	Institucioni përgjegjës	Përkrahësit	Ksostoja financiare / Implementimi			
						2017	2018	2019	2020
1.1 Përkrahja e festivaleve dhe aktiviteteve tjera tradicionale që ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes në jetën kulturore	<p>1.1.1. Merret vendimi për themelimin e fondit</p> <p>1. 1.2. Alokimi i një fondi të veçantë për mbështetje të skenës së pavarur</p> <p>1.1.3. Ndarja e një kodi të veçantë për mbështetjen e skenës së pavarur</p> <p>1.1.4. Hartimi dhe përditësimi i kalendarit kulturor online</p>	<p>Vendimi i miratuar</p> <p>Vendimi për alokim fondi,</p> <p>Vendimi për kodin,</p> <p>Kalendari i përditësuar</p>	<p>Dokumenti i vendimit,</p> <p>Dokumenti i vendimit,</p> <p>Dokumenti i vendimit,</p> <p>Kalendari i përditësuar online</p>	<p>DKRS²</p> <p>DF³</p>	<p>RrOK⁴</p> <p>Donatorët</p>				
1. 2. Shfrytëzimi i hapësirave publike për rritjen e çasjes në aktivitete kulturore	<p>1. 2.1. Të inventarizohen hapësirat publike për zhvillimin e aktiviteteve komunitare</p> <p>1. 2.2. Sigurimi i mirëmbajtjes së</p>	<p>Raporti përmbledhës i hapësirave të inventarizuara,</p> <p>Vendimi për</p>	<p>Raporti,</p> <p>Vendimi,</p> <p>Vendimi,</p>	<p>DKRS</p> <p>DShP⁵</p> <p>DUPh</p>	<p>RrOK</p>				

² DKRS - drejtorja për kulturë, rinë dhe sport

³ DF - drejtorja e financave

⁴ RrOK - rrjeti i organizatave të kulturës

⁵ DShP - drejtorja e shërbimeve publike

	hapësirave publike 1.2.3.Sigurimi i një fondi të vecante për mbështetje të artit në hapësira publike	mirëmbajtje, Vendimi për themelim të fondit							
1.3 Ruajtja e laramanisë kulturore dhe e gjuhëve të Prizrenit	1.3.1.Të dokumentohet diversiteti kulturor në komunën e Prizrenit 1. 3.2.Të dokumentohet diversiteti gjuhësor në komunën e Prizrenit 1. 3.3.Të zhvillohet lënda shkollore për gjuhën dhe kulturën e komuniteteve në komunën e Prizrenit 1.3.4.Mbështeten hulumtime shkencore të cilat e dokumentojnë diversitetin kulturor të Prizrenit	Raporti nga procesi i dokumentimi të diversitetit kulturor, Raporti nga procesi i dokumentimit të diversitetit gjuhësor, Vendimi i DKA për lëndën jasht-kurrikulare, Numri i hulumtimeve të mbështetura	Raporti, Raporti, Vendimi, Raportet nga hulumtimet	DKRS	RrOK Donatorët				
1. 4.Krijimi i çasjes fizike për PNV në institucionet kulturore	1.4.1.Çasje e siguruar për PNV në institucione kulturore	Numri i institucioneve kulturore me çasje të siguruar	Lista e institucioneve kulturore me çasje të	DShP DKRS	RrOK Hendikos				

	1.4.2.Çasje e siguruar për PNV në objekte të trashëgimisë kulturore	për PNV, Numri i objekteve të trashëgimisë me çasje të siguruar për PNV,	siguruar për PNV, Lista e objekteve të trashëgimisë me çasje të siguruar për PNV,						
	1.4.3 Çasje e siguruar për PNV në hapësira publike	Numri i hapësirave publike me çasje të siguruar për PNV	Lista me emra të hapësirave publike me çasje të siguruar për PNV,						
Gjysmë total për vit									
Objektiva strategjike II: Zhvillimi i Turizmit kulturor dhe Ekonomisë kulturore									
Masat	Veprimet	Treguesit	Burimet	Institucioni përgjegjës	Përkrahësit	Ksostoja financiare			
						2017	2018	2019	

<p>2.1.Ruajtja,menaxhimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore</p>	<p>2.1.1.Hartohet plani i menaxhimit të konzervimit te qendrës historike</p> <p>2.1.2.Alokohet buxhet i mjaftueshëm për zbatimin e planit</p> <p>2.1.3.Funksionalizohet zyra për qendrën historike të Prizrenit</p> <p>2.1.4.Të bëhet inventarizimi i kujtesës kolektive për qytetin e Prizrenit</p> <p>2.1.5.Mbështetja e publikimeve me karakter promovimi të vlerave të trashëgimisë kulturore</p>	<p>Plani i menaxhimit i hartuar,</p> <p>Buxheti i alokuar,</p> <p>Numri i dokumenteve, vendimeve të prodhuara nga zyra,</p> <p>Numri i aktiviteteve të ndërmarra,</p> <p>Numri i publikimeve të mbështetura</p>	<p>Plani menaxhimit,</p> <p>Vendimi për alokim të buxhetit,</p> <p>Dokumente dhe vendimet,</p> <p>Raporti nga inventarizimi,</p> <p>Publikimet</p>	<p>DKRS</p>	<p>QRTK⁶</p> <p>RrOK</p> <p>Donatorët</p>				
<p>2.2.Zhvillimi dhe promovimi i turizmit kulturor</p>	<p>2.2.1.Zhvillimi i pakove turistike në bashkëpunim me operatorët turistik për</p>	<p>Numri i pakove të zhvilluara,</p> <p>Numri i</p>	<p>Lista me pako,</p> <p>Lista me emra</p>	<p>DTZhe⁷</p> <p>DKRS</p>	<p>RrOK</p> <p>ShOT⁸</p>				

⁶ IMMP - Qendra Rajonale per Trashegimi Kulturore Prizne

⁷ DTZhe - drejtorja e turizmit dhe zhvillimit ekonomik

⁸ ShOT - Shoqata e operatorwve turistik

	<p>një periudhë dy-vjeqare</p> <p>2.2.2.Adaptimi i hapësirave publike/private për organizimin e turizmit të konferencave</p> <p>2.2.3.Inspektimi sanitar për hoteleri</p> <p>2.2.4.Funkcionalizimi i Info-Qendrave turistike dhe online platformave</p> <p>2.2.5.Kalendari kulturor funksional dhe i përditësuar</p>	<p>operatorëve turistik të përfshirë,</p> <p>Numri i hapësirave publike të adaptuara,</p> <p>Numri i ngjarjeve të organizuara,</p> <p>Numri i inspektimeve,</p> <p>Numri i Info - qendrave të funksionalizuara,</p> <p>Numri i mediave ku mund të gjendet kalendari kulturor</p>	<p>të operatorëve,</p> <p>Lista me emra të hapësirave,</p> <p>Lista e ngjarjeve,</p> <p>Raportet nga inspektimet,</p> <p>Lista e info-qendrave dhe on-line platformave,</p> <p>Kalendari kulturor</p>		Donatorët				
2.3. Brendimi i qytetit të Prizrenit	<p>2.3.1.Inventarizimi i produkteve për mundësi brendimi</p> <p>2.3.2.Mandatimi i një grupi multisektorial për</p>	<p>Numri i produkteve të inventarizuara,</p> <p>Numri i personave të</p>	<p>Lista e produkteve,</p> <p>Vendimi për mandatin,</p>	<p>DTZhe</p> <p>DKRS</p> <p>DShP</p>	<p>RrOK</p> <p>AZhR⁹</p> <p>QRTK</p>				

⁹ AZhR - agjencioni zhvillimor rajonal

	<p>brendimin e qytetit dhe produkteve lokale.</p> <p>2.3.3.Zhvillikmi i një brend-book`u</p> <p>2.3.4.Promovimi i mundësive dhe potenciali turistik në media të fuqishme të huaja</p> <p>2.3.5.Zbatimi i udhëzimeve të derivuara nga brend-book`u</p>	<p>përfshirë në grup,</p> <p>Numri i aktiviteteve për hartimin e brend-book`ut,</p> <p>Numri i ngjarjeve promovuese dhe mediave të përfshira në promovim,</p> <p>Numri i udhëzimeve të zbatuara</p>	<p>Brend book`u,</p> <p>Artikujt,video-prezantimet,</p> <p>Udhëzimet nga brend - book`u</p>		Donatorët				
2.4.Stimulimi i ringjalljes së artizanateve të vjetra	<p>2.4.1.Dokumentimi i kujtesës kolektive për zanatet dhe zejjet tradicionale</p> <p>2.4.2.Identifikimi i zanateve të cilat kanë potencial të të jetuarit në zhvillimet ekonomike të kohës</p>	<p>Numri i zanateve tradicionale të dokumentuara,</p> <p>Numri i zanateve potenciale për mbijetim të identifikuara,</p> <p>Numri i artizanateve të</p>	<p>Raporti nga dokumentimi,</p> <p>Lista e zanateve,</p> <p>Lista e zanateve në panair</p>	<p>DKRS</p> <p>DShP</p> <p>DTZHE</p>	<p>RrOK</p> <p>Donatorët</p>				

	2.4.3.Organizimi dhe mbështetja e panairit veror për punë dore dhe artizanate	përfshira në panair							
Objektiva strategjike III: Reforma e qeverisjes së kulturës									
Masat	Veprimet	Treguesit	Burimet	Institucioni përgjegjës	Përkrahësit	Kostoja financiare			
						2017	2018	2019	
3.1.Ristrukturimi institucional i sektorit të kulturës në komunë	3.1.1.Rishikimi funksional i sektorit institucional të kulturës 3.1.2.Themelimi i këshillit për kulturë 3.1.3.Ndryshimi i mënyrës së buxhetimit institucional të kulturës të	Numri i akterëve të përfshirë në procesin e rishikimit, Numri i çështjeve të rishikuara, Këshilli i	Lista me emra të akterëve, Lista e çështjeve, Vendimi për themelimin të këshillit, Lista me emra të	AK ¹⁰ DKRS DF DShP	RrOK Donatorët				

¹⁰ AK - asambleja komunale

	buxhetit komunal	themeluar, Numri i anëtarëve të këshillit, Kriteret dhe metodologjia për ndryshim të mënyrës së buxhetimit	anëtarëve të këshillit, Dokumenti me kritere dhe metodologji për ndryshim të mënyrës së buxhetimit						
3.2.Konsolidimi i shkathtësive menaxheriale të akterëve të kulturës për çasjen e re në menaxhim kulturor	3.2.1.Hartimi i një pakoje trajnimi 3.2.2.Organizimi i një cikli të punëtorive për menaxhim kulturor 3.2.3.Krijimi i një sistemi vlerësimi i performancës së akterëve kulturor institucional	Pakoja e hartuar, Numri i moduleve të përfshira në pako, Numri i punëtorive të organizuara, Sistemi i vlerësimit i krijuar,	Pakoja trajnuese, Lista e moduleve të përfshira në pako, Raportet nga punëtoritë, Listat e pjesëmarrësve, Akti themelues për sistem vlerësimi,	DKRS	RrOK Donatorët				
3.3. Edukim artistik në	3.3.1.Hartimi i një manuali	Numri i	Manuali i	DKA	RrOK				

<p>shkolla fillore dhe të mesme të komunës</p>	<p>për funksionimin e edukimit artistik në shkolla</p> <p>3.3.2.Themelimi i njësive artistike nëpër shkollat e komunës</p> <p>3.3.3.Financimi i përkohshëm i njësive artistike</p> <p>3.3.4.Themelimi i skemës së subvencionimit të nxënësve për të ndjekur ngjarjet kulturore</p>	<p>profesionistëve të përfshirë në procesin e hartimit</p> <p>Numri i shkollave të cilat themeluan njësitë artistike,</p> <p>Numri i njësive të financuara,</p> <p>Kohëzgjatja e financimit të njësive artistike,</p> <p>Skema e subvencionimit e themeluar,</p> <p>Shuma e mjeteve financiare e alokuar,</p> <p>Numri i nxënësve përfitues nga</p>	<p>hartuar,</p> <p>Vendimi për themelimin e njësive artistike,</p> <p>Raportet financiare nga njësitë e financuara,</p> <p>Lista e njësive të financuara,</p> <p>Plani për financimin e njësive artistike,</p> <p>Vendimi për themelimin e skemës së subvencionimit,</p> <p>Pasqyrat financiare ,</p> <p>Lista e nxënësve përfitues,</p>	<p>DKRS</p> <p>DF</p>	<p>Donatorët</p>				
--	--	---	--	-----------------------	------------------	--	--	--	--

		skema							
--	--	-------	--	--	--	--	--	--	--

VI.Referencat

(përshkrimi sipas nevojës)